



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.10.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i projektprogramit të punës së Kuvendit për periudhën 21 tetor – 13 dhjetor 2019.
2. Miratimi i projektkalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 28 tetor – 15 nëntor 2019.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Rudina Hajdari -	Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat / Kryetare e Komisionit për Integrimin European
Adriatik Alimadhi -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partive të Djathta
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Edlira Hyseni -	Zëvendëskryetare e Grupit Parlamentar të Pavarur
Klodiana Spahiu -	Zëvendëskryetare e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

Mungojnë:

Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Myslim Murizi -	Zëvendëskryetar i Kuvendit
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Fatjona Dhimitri -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Mirëmëngjesi!

Të nderuar anëtarë të Konferencës së Kryetarëve, po hapim mbledhjen me rend dite, miratimin e projektprogramit të punës së Kuvendit për periudhën 21 tetor deri 13 dhjetor 2019 dhe miratimin e projektkalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 28 tetor – 15 nëntor 2019.

Me projektprogramin dhe projektkalendarin jeni njohur paraprakisht. Në projektkalendar janë parashikuar 3 seanca plenare, respektivisht në datat 28 tetor, e hënë, ora 17.00. 4 nëntor, e hënë, ora 10.00 dhe 14 nëntor e enjte, ora 10.00.

Nga anëtarët e Konferencës, ka sugjerime apo mendime?

Fjala për ju zoti Balla!

Taulant Balla – Sikurse Ju njoftuat, pas kërkesës tonë në mbarim të seancës plenare të datës 9 tetor 2019, lidhur me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008, “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, të ndryshuar, ne si grup parlamentar kishim parashtruar që ky projektligj të diskutohej përsëri nga komisioni përgjegjës për amendamentet e propozuara në seancë si dhe të kalojë për mendim në Komision të Veprimtarive Prodhuese. Ashtu si e përcakton dhe Rregullorja, përfshirja e një komisioni tjetër duhet të kalojë nëpërmjet Konferencës së Kryetarëve. Në këtë kontekst bëra njoftimin që ky projektligj të diskutohej edhe në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese për dhënie mendimi. Më tej pasi ta ketë shqyrtuar edhe ky komision të kalojë në seancë plenare.

Gramoz Ruçi – Dakord, të kalojë në Komision të Veprimtarive Prodhuese dhe të vijojë puna për t’u paraqitur në seancë plenare.

Adriatik Alimadhi – Zoti Kryetar, në seancën plenare të kaluar, së bashku me deputetin Zef Shtjefni paraqitëm disa problematika, lidhur me kontaktet me qytetarët. Kur shkoj në takimet në zona kemi një problem, pasi nuk kemi zyra, sekretarë. Është shumë e vështirë kontakti me qytetarët, duke parë dhe situatën politike.

Gramoz Ruçi – Lidhur me zyrat dhe sekretarët duhet të dini që, në 12 qarqe janë 24 zyra.

Së pari, në 24 zyra, 12 zyra i ka mazhoranca dhe 12 opozita. Kur flas për mazhorancën i referohem të gjithë grupeve të mazhorancës, njëkohësisht kur flas për opozitën, i referohem të gjithë grupeve të opozitës.

Së dyti, lidhur me sekretarët, çdo zyrë ka një sekretar! Ai sekretar që është caktuar duhet të gjejë konsensusin e të gjithë grupeve që janë aty. Në dijeninë time një apo dy qarqe janë pa zyra dhe pa sekretarë, të tjerat janë të kompletuara.

Adriatik Alimadhi – Sikurse e shpreha, se situata politike është shumë e vështirë. Unë shkoj në Vlorë dhe njerëzit më sulen si tradhtar e ku di unë çfarë tjetër. Ku do ulemi ne dhe ku do kontaktojmë, pasi nuk mund të ulemi në terren dhe nëpër kafe! Të dy grupet parlamentare i kanë ndarë zyrat, për ne nuk ka asgjë. Të shikohet mundësia, sepse situata politike është problem për ne dhe jo për ju.

Gramoz Ruçi – Të lutem, atje një zyrë është. Sekretari duhet të mbajë zyrën hapur, t'ju presë Ju dhe të mbajë shënime. Zyrë tjetër nuk ka. Kjo është e parashikuar me ligj dhe me vendim Byroje.

Sugjerime dhe mendime të tjera keni?

Nuk ka, projektprogrami dhe projektkalendari t'i kalojnë për njoftim seancës plenare.

Këtu e mbylлим, faleminderit.

MBYLLET MBLEDHJA